



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republik of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Nr.02-111/01-0002405/21
Podujevë,
Më:13.01.2021

SHPALLJE PUBLIKE

Për angazhimin e punëtorëve me Kontratë për Punë dhe Detyra Specifike
(Procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit)

Komuna e Podujevës bën Shpallje Publike duke u bazuar në LIGJIN Nr. 03/L-212 të Punës, Neni 10 dhe kërkesës së Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, e cila përmes Kontratës për Punë dhe Detyra Specifike kërkon angazhimin e punëtorëve për ofrimin e shërbimeve të nevojshme në QKMF.

Kohëzgjatja e Kontratës për Punë dhe Detyra Specifike është Katër (4) muaj

I.Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Pozita: Teknik i Laboratorit - Dy (2) pozita

Paga: 425 Euro Bruto

**Kualifikimi: Diplomë e Shkollës së Mesme të Mjekësisë - Drejtimi Teknik
Laboratori**

Përshkrimi i detyrave të punës :

- Bënë pranimin dhe evidentimin e pacientëve të cilët me udhëzim të mjekëve vijnë për analiza laboratorike.
- Bënë pranimin e materialit për analiza.
- Vendos sendimentacionet dhe përcakton vlerat.
- Bënë leximin e pasqyrave të gjakut.
- Pranon urinat i punon dhe bëjnë etiketimin e tyre.
- Bënë leximin e sendimentacionit të urinës në mikroskop.
- Kryen analizat biokimike siç janë glikemia, kreatinina, kolesterolit, trigliceridet, ALT-AST, hepatogrami.
- Sterilizon mjetet e punës.
- Për punën e vet i përgjigjet shefit të shërbimit dhe Drejtorit.

II. Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Pozita: Teknik të Rëntgenit - Dy (2) pozita

Paga: 425 Euro Bruto

Kualifikimi: Diplomë e Shkollës së Mesme të Mjekësisë - Drejtimi Teknik Rentgeni

Përshkrimi i detyrave të punës :

- Përgatitë vendin e punës (aparartet,veglat dhe materialin) bënë identifikimin e pacientit para fotografimit e vendos të sëmurin në pozitën përkatse në bazë të fotografimit që bënë.
- Radiografitë i bënë në mënyrë profesionale, kryen kontrollin e përpunimit teknik të rëntgenit.
- Konsulton radiologun për kualitetin dhe inqizimin plotësues.
- Bënë pranimin dhe fotografimin e pacientëve në bazë të udhëzimit të mjekut.
- Bënë ndrrimin e kimikaleve në aparatit e zhvilluesit të filmave.
- Radiografitë e kryera me dokumentacion përkatës i përcjell te radiologu i cili i i interpreton dhe përshkruan.
- Bënë koordinimin me radiolog dhe administratë.
- Kujdeset për mjete e punës (kasetat, filmat e rëntgenit, kimikatet etj.).
- Mbanë dozimetrit për kontrollë dhe dozat e pranimit të rrezatimit (një herë ne vit shkon në entet përkatëse për kontrollim të rrezatimit).
- Rreptësisht ruan fshehtësinë profesionale e cila ka të bëjë me sëmundjet e pacientit.
- Kujdeset për mirëmbajtjen (pastërtinë) e aparaturës.
- Kryen edhe punë tjera laboratorike - RO filmat
- Gjatë punës është obligim mbajtja e dozimetrit dhe mjeteve mbrojtëse të punës
- Kryen edhe punë tjera në kuadër të kualifikimit nga fushëveprimtaria e tij/saj.
- Bënë kërkesat për furnizim me materjal hargjues.
- Mbanë ruan dozimetrat.
- Për punën e vet i përgjigjet shefit të shërbimit dhe Drejtorit.

III. Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Pozita: Infermier/e, Tetë (8) pozita

Paga : 377 Euro Bruto

Kualifikimi: Bachelor Infermieri apo Diploma e Shkollës së Mesme të Mjekësisë - Drejtimi i përgjithëshem, e domosdoshme Licenca e Punës

Përshkrimi i detyrave të punës :

- Pranon, triazhon dhe informon pacientin,hap kartelen shendetësore,merr anamnezen e shkurter orjentuese,kryen participimin,matë gjatësin,peshën trupore,temperaturën,tensionin arterial,reanimimin kardiopulmonar,bën EKG,problemet geriatrike,aplikon terapin parenteriale,IM,IV,subkutan,infuzion,inhalimin,përpunimin e plagës,këshillon pacientin,dh e udhëzon te mjeku familjar.
- Në bashkëpunim me mjekun familjar ofron mbrojtjen primare shendetësore për pacientin dhe familjen.
- Këshillon nënat për ushqimin e fëmijëve,mban kuzhinen demonstruese,bën inhalime në bazë të udhëzimeve mjeksore.

- Kryen shërbime të shëndetit reprodaktiv,kujdesin antenatal dhe post natal,shërbime shendetësore për fëmijë(përcjell rritjen dhe zhvillimin fizik dhe psikomotorik).
- Bën imunizimin,përcjell kalendarin e imunizimit,aplikon dhënjën e oksigjenit,cakton sheqerin në gjak me glykometer në raste urgjente,bën lavazhjen e veshit,audiogramet.
- Promovon edukimin shendetësor.
- Trajton lëndimet-plagët para dhe post operative.
- Jep ndihëmen shendetësore në Institucion dhe vendin e ngjarjes.
- Kryen vizita shtepiake kur është e domostoshme me udhëzim të mjekut.
- Bën injektimin e të gjitha mënyrave të mundshme (IM,IV,SC,ID etj)
- Kryen të gjitha punët administrative në lidhje me shërbimet që i bën.
- Kryen edhe punë tjera sipas udhëzimit të mjekut.
- Për punët e veta i përgjigjet Mjekut dhe stafit udhëheqës.

IV. Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Pozita: Mjek i Përgjithshëm në QKMF - Podujevë, Tri(3) pozita

Paga : 565 Euro Bruto

Kualifikimi: - Diploma e Fakultetit të Mjekësisë - Drejtimi i Përgjithshëm, e domosdoshme Licenca e Punës

Përshkrimi i detyrave të punës :

- Ofron mbrojtjen primare shëndetsore për pacientin dhe familjen.
- Pranon pacientin nga Infermierja, shenon të dhënat në kartelë shendetësore, merr anamnezën, bënë ekzaminimin e pacientit (inspektimin, auskultimin, palpacionin dhe perkusionin), reanimimin kardio pulmonar dhe referon pacientin për hulumtime të tjera dijagnostike.
- Bënë diagnozen iniciale dhe trajtimin me terapi adekuate,
- Udhëzon tek specialisti konsulltant nëse është e nevojshme konsullta,
- Kryen shërbime ne kuader të shëndetit reprodaktiv,kujdesit antenatal dhe postnatal
- Bënë imunizimin (vaksinimin),
- Promovon edukimin shëndetsor,
- Trajton lëndime të vogla,
- Kryen vizita shtëpiake kur është e domosdoshme
- Bënë identifikimin e grupeve vulnerabile dhe të rrezikuara
- Bënë dhënjën e barërave dhe medikamenteve esenciale
- Gjatë punës së tij i asistojnë infermieret
- Për punën e vet i përgjigjet Kryeshefit të DMF dhe Drejtorit

INFORMATË PËR TË GJITHË APLIKANTËT

Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin:

- CV
- Certifikatën që ndaj tij nuk janë duke u zhvilluar hetime
- Kopjen e leternjoftimit
- Kopjen e Dokumentacionit për kualifikimin dhe kushtet e kërkuara sipas Konkursit

Data e shpalljes : 13.01.2021 deri më 17.01.2021

Komuna e Podujevës ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e administratës publike qendrore dhe lokale.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi mbetet i hapur **5 ditë** nga data e shpalljes në mjetet e informimit publik dhe në tabelën e shpalljeve.

Fletëaplikacionet merren në Qendrën e Shërbimit për Qytetarë, në ndërtesën e Kuvendit të Komunës.

Kërkesat me dokumente të kompletuara dorëzohen në Qendrën e Shërbimit për Qytetarë.

**Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi**

